



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E BUJQËSISË PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

► Puna e rrezikshme e fëmijëve në bujqësi dhe pylltari

Udhëzues për këshilltarë
komunal për bujqësi dhe
zhvillim rural

► PUNA E RREZIKSHME E FËMIJËVE NË BUJQËSI DHE PYLLTARI

UDHËZUES PËR KËSHILLTARË KOMUNAL PËR BUJQËSI
DHE ZHVILLIM RURAL

► FALËNDERIME

Ky dokument është pjesë e projektit projektit “Masat, ndërgjegjësimi dhe përfshirja e politikave në përsheptimin e veprimeve kundër punës së fëmijëve dhe punës së detyruar (MAP 16)” në mbështetje të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) Caku 8.7. Fondet janë mundësuar nga Departamenti i Punës i SHBA-së në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me numër IL-30147- 16-75-K-11. 100% e të gjitha shpenzimeve të projektit financohen nga fondet federale, në vlerë prej 22,4 million dollarësh, prej të cilave USD 274,000 janë alokuar për aktivitetet në Kosovë.

Ky material nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet ose politikat e Departamentit të Punës të Shteteve të Bashkuara, dhe as përmendja e emrave tregtarë, produkteve komerciale ose organizatave nuk nënkupton miratimin nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara.

▶ PËRMBAJTJA

▶ HYRJE	7
▶ KAPITULLI I. TË KUPTUARIT E PUNËS SË FËMIJËVE	9
▶ 1.1. Përkufizimi i punës së fëmijëve	10
▶ 1.2. Pasojat e punës së fëmijëve	13
▶ KAPITULLI II. KONTEKSTI I PUNËS SË RREZIKSHME TË FËMIJËVE NË BUJQËSI DHE PYLLTARI	14
▶ 2.1 Sektori i Bujqësisë	16
▶ 2.2 Situata dhe shkaqet e punës së fëmijëve në sektorin e bujqësisë dhe pylltarisë	16
▶ KAPITULLI III. ÇKA DUHET TË DIJNË FERMERËT?	21
▶ 3.1 Cilat aktivitete bujqësore janë të ndaluara për fëmijët dhe pse	24
▶ 3.1.1 Aktivitetet e ndaluara për fëmijë në blegtori	24
▶ 3.1.2 Aktivitetet e ndaluara për fëmijë në pemtari dhe vreshtari	27
▶ 3.1.3 Aktivitetet e ndaluara për fëmijë në perimekulturë me lavërtari	28
▶ 3.1.4 Aktivitetet e ndaluara për fëmijë në mbrojtjen e bimëve	31
▶ 3.1.5 Aktivitetet e ndaluara për fëmijë në ujitje	32
▶ 3.1.6 Aktivitetet e ndaluara për fëmijë në aplikimin e plehrave minerale dhe organike	32
▶ 3.1.7 Aktivitetet e ndaluara për fëmijë në pylltari	33
▶ 3.1.8 Aktivitetet e ndaluara për fëmijë në bujqësinë organike	36
▶ 3.1.9 Ndalesat në përdorimin e mekanizimit bujqësor	37
▶ 3.1.10 Aktivitetet e ndaluara për fëmijë në agropërpunim	39
▶ 3.1.11 Aktivitetet e ndaluara për fëmijë në sektorin jo bujqësor	39
▶ 3.2 Cila punë është e përshtatshme për fëmijë?	40
▶ REFERENCAT	43

► Hyrje

Edhe pse nuk ka të dhëna të plota statistikore, përfshirja e fëmijëve në punë të rrezikshme në bujqësi dhe pylltari është dukuri mjaft e shprehur në zonat rurale. Këta fëmijë, duke filluar nga mosha 11 vjeçare, rrezikohen nga makineria e rëndë dhe e rrezikshme bujqësore, mjetet e mprehta, temperaturat ekstreme, lagështia, pluhuri dhe gazrat organike, rryma, uji i ftohte, peshat e rënda, orari i gjatë i punës, pozitat e papërshtatshme si dhe terreni i papërshtatshëm i punës. Për më tepër, procesi i shkollimit për këta fëmijë është i vështirësuar ose i pamundur, ndërsa mundësitë për shfrytëzim të kohës së lirë janë shumë të kufizuara.

Pas një pune të vazhdueshme të Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) në përcaktimin e aktiviteteve të rrezikshme për fëmijë në sektorin e bujqësisë dhe pylltarisë dhe në sensibilizimin e fermerëve mbi rreziqet e punës së fëmijëve në bujqësi dhe pylltari, MBPZHR gjatë vitit 2021 me mbështetje të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ONP-së) intensifikoi angazhimet për të identifikuar masat që mund të ndërmerren nga MBPZHR dhe agjencitë ekzekutive të saj për parandalimin e punës së rrezikshme në bujqësi dhe pylltari, por edhe për mbrojtjen e fëmijëve që aktualisht janë të përfshirë në punë të rrezikshme. Në linjë me obligimet që dalin nga Ligji Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës dhe në frymën e kontributit për tema të interesit nacional, MBPZHR është e përkushtuar që të siguroj se:

- Informimi dhe vetdijësimi i fermerëve për rreziqet dhe pasojat e angazhimit të fëmijëve në aktivitete të caktuara bujqësore të përfshihet në të gjitha konsultimet dhe fushatat që organizohen me fermerë¹;
- Të gjitha kontratat e MBPZHR dhe agjencive të saj ekzekutive me operatorë ekonomik dhe me fermerë të përmbajnë ndalesën për angazhimin e personave nën moshën 18 vjeçare në punë të rrezikshme dhe/apo në aneks do të kenë të bashkëngjitur letër informimin për aktivitetet e rrezikshme në sektorin përkatës të veprimtarisë;
- Kuadri ligjor i MBPZHR shprehimisht i kontribuon parandalimit dhe ndalimit të angazhimit të fëmijëve në aktivitete të rrezikshme në sektorin e bujqësisë dhe pylltarisë;
- Programet e investimit në zhvillim rural dhe në zhvillim të bujqësisë i kontribuojnë shmangies së varësisë së familjeve në zonat rurale nga puna e fëmijëve, si dhe punësimit të denjë të rinjve në bujqësi;
- Rastet e identifikuar të fëmijëve në forma të rrezikshme të punës në sektorin e bujqësisë dhe pylltarisë të referohen në Qendrën për Punë Sociale.

Në linjë me këto prioritete, Departamenti i Shërbimeve Këshillimore për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në MBPZHR ka marrë përsipër që, me mbështetje të Projektit MAP 16 të ONP-së, të:

- hartoj këtë Udhëzues për këshilltarët komunal për bujqësi dhe zhvillim rural mbi format e rrezikshme të punës së fëmijëve në bujqësi dhe pylltari;
- organizoj punëtori për ngritjen e kapacitetit të këshilltarëve komunal për këshillimin e fermerëve mbi format e rrezikshme të punës në kuadër të këshillimeve të rregullta me ta (sic parashihet me planin vjetor të këshillimit të fermerëve);
- këshilloj fermerët mbi aktivitetet e rrezikshme për fëmijë në veprimtaritë e caktuara bujqësore, në kuadër të këshillimeve të rregullta që mbahen me fermer nga këshilltarët komunal;

¹ Sidomos në kuadër të sesioneve informuese për promovimin e masave për zhvillim rural, në kuadër të fushatave për mbrojtje të pyjeve si dhe në kuadër të sesioneve këshilluese me fermer që realizohen nga Këshilltarët komunal për bujqësi dhe zhvillim rural

- përfshijë informacion bazik mbi aktivitetet e rrezikshme për fëmijë (përfshirë rreziqet dhe efektin e tyre në shëndetin dhe zhvillimin e fëmijës) në veprimtaritë e caktuara bujqësore, në kuadër të broshurave për fermer që përgatiten nga DShK;
- përgatis një video sensibilizuese për format e rrezikshme të punës së fëmijëve në bujqësi dhe pylltari, për postim në rrjetet sociale dhe uebfaqen zyrtare të MBPZHR.

Ky udhëzues është hartuar si ndihmesë për këshilltarët komunal për bujqësi dhe zhvillim rural që të kuptojnë natyrën e punës së rrezikshme të fëmijëve dhe që të ndërmarrin veprime në vetëdijesimin e fermerëve për rrezikun e angazhimit të fëmijëve në aktivitete të caktuara bujqësore. Me idenë që këto çështje të trajtohen me fermerë në kuadër të trajnimeve dhe konsultimeve direkte që do të zhvillohen me ta mbi veprimtaritë e ndryshme bujqësore, pjesa kryesore e Udhëzuesit është organizuar sipas temave të parapara nga ana e MBPZHR, për trajnimin dhe këshillimin e fermerëve.

Pas sqarimit të përkufizimeve kryesore, situatës, shkaqeve dhe pasojave të punës së fëmijëve në përgjithësi dhe veçanërisht në bujqësi dhe pylltari, në kapitullin e tretë, për secilën veprimtari bujqësore janë listuar aktivitetet e rrezikshme që nuk duhen kryer nga fëmijët, rreziqet e ndërlidhura me to dhe ndikimi potencial i këtyre rreziqeve në shëndetin dhe zhvillimin e fëmijës. Por, duke pasur parasysh edhe rëndësinë e përfshirjes graduale të fëmijëve në aktivitete punuese për të zhvilluar ndjenjën e dashurisë për punë, për bimët, kafshët dhe natyrën në përgjithësi, Udhëzuesi poashtu ofron orientime për format e përshtatshme të punës në bujqësi si dhe për vlerësimin e rrezikshmërisë së aktiviteteve të ndryshme bujqësore.

Rrjedhimisht, nga këshilltarët pritet që krahas këshillave teknike për veprimtaritë e caktuara bujqësore të informojnë fermerët edhe për aktivitetet e ndaluara për fëmijë në fushat përkatëse të veprimtarisë që ata ushtrojnë, rreziqet që paraqesin ato për fëmijën, si dhe për mënyrën e vlerësimit të përshtatshmërisë së aktiviteteve të caktuara që mund të kryhen edhe nga fëmijët, konform kufizimeve të moshës së tyre.



Të kuptuarit e punës së fëmijëve



1.1 Përkufizimi i punës së fëmijëve

Jo të gjitha punët që kryejnë fëmijët dhe adoleshentët duhen të klasifikohen si punë e fëmijëve dhe duhet të eliminohen. Pjesëmarrja e fëmijëve ose e adoleshentëve në punë që nuk ndikon në shëndetin dhe zhvillimin e tyre personal, ose që nuk ndërhyt në shkollimin e tyre, në përgjithësi konsiderohet si pozitive. Kjo përfshin aktivitete të tilla si të ndihmshëm prindërit rreth shtëpisë, të ndihmshëm në një biznes familjar ose të fitosh para jashtë orëve të mësimi dhe gjatë pushimeve shkollore.

Termi "**punë e fëmijëve**," përkufizohet si punë që privon fëmijërinë e fëmijës, potencialin dhe dinjitetin e tij/saj, është e dëmshme për zhvillimin fizik, mendor, social e moral të fëmijës si dhe ndërhyt në shkollimin e tij/saj. Ndërhyrje në shkollim konsiderohet kur fëmija (a) privohet nga mundësia për të ndjekur shkollën, (b) detyrohet që ta ndërpres shkollimin para kohe, ose (c) sforcohet që ta ndjek shkollën në kushte shumë të vështira.

Përderisa puna e fëmijëve merr shumë forma të ndryshme, prioritet është të eliminohen pa vonesë **format më të këqija të punës së fëmijëve**, siç përcaktohet në nenin 3 të Konventës së ONP-së për format më të këqija të punës së fëmijëve nr. 182 (1999). Format më të këqija të punës së fëmijëve përfshijnë: të gjitha format e skllavërisë ose praktikave të ngjashme me skllavërinë, të tilla si shitja dhe trafikimi i fëmijëve, detyrimi skllavërues dhe bujkrobëria dhe puna pa dëshirë ose e detyruar, përfshirë rekrutimi pa dëshirë ose të detyruar për përdorim në konflikte të armatosura;

- a) përdorimin, kërkimin ose dhënien e një fëmije për prostitucion, për prodhim pornografie ose për shfaqje pornografike;
- b) përdorimin, kërkimin ose dhënien e një fëmije për veprimtari të paligjshme, në veçanti për prodhimin dhe trafikimin e drogave narkotike sikundër janë përkufizuar në traktatet përkatëse ndërkombëtare;
- c) punët të cilat, nga natyra ose rrethanat në të cilat kryhen mund të rrezikojnë shëndetin, sigurinë ose moralin e fëmijëve.

Shtetet duhet të përcaktojnë që tri kategoritë e para (a, b dhe c) të formave më të këqija të punës së fëmijëve janë vepra penale.

Kategoria e katërt (d) cilësohet si punë e rrezikshme e fëmijëve dhe i referohet punës që ka gjasa të rezultojë në vdekjen e fëmijës, lëndimin (shpeshherë për gjithë jetën) ose sëmurjen (shpeshherë për gjithë jetën) për shkak të natyrës së punës ose si pasojë e vendit jo të sigurt të punës, standardeve të ulëta të sigurisë dhe shëndetit dhe kushteve dhe rregullimeve të punës.

Tabela 1. Konceptet kryesore të punës së fëmijëve

Grupmoshat	Format e Punës		
	Puna që nuk është e rrezikshme	Format më të këqija të punës së fëmijëve	
		Puna e rrezikshme	Format tjera më të këqija
5-11	1 orë në javë aktivitet ekonomik dhe/ose ≤ 21 orë në javë në shërbime shtëpiake të papaguara	>1 orë në javë aktivitet ekonomik në industri specifike dhe/ose > 21 orë në javë në shërbime shtëpiake të papaguara	Fëmijët e trafikuar, të angazhuar në punë të detyruar, në konflikte të armatosura, prostitucion dhe pornografi, aktivitete në konflikt me ligjin
12-14	≤ 14 orë në javë në industri specifike	>14 orë në javë dhe në industri specifike	
15-17	≤ 30 orë në javë në industri specifike	> 30 orë në javë dhe në industri specifike	

► **Kujdes!**

Në kategorinë (c) përfshihet edhe angazhimi i fëmijëve për prerje ilegale të pyjeve, për kontrabandim të kafshëve apo për forma të ndaluara të peshkimit, prandaj përbën veper penale.

Në përputhje me Konventën 182 të ONP-së, puna e detyruar, rekrutimi i fëmijëve për përdorim në konflikt të armatosur, trafikimi i fëmijëve, përdorimi i fëmijëve për prostitucion dhe pornografi, dhe aktivitetet e paligjshme në Kosovë janë të ndaluara nga Kodi Penal.

Sa i përket punës së rrezikshme për fëmijët, versioni i parë i listës së punëve të rrezikshme për fëmijë në Kosovë është përgatitur me mbështetjen e ONP-së gjatë periudhës 2005-2007, dhe ka hyrë në fuqi ligjërisht si Udhëzim Administrativ i Qeverisë për Parandalimin dhe Eliminimin e Punëve të Rrezikshme për Fëmijë në Kosovë (UA 17/2008).

Udhëzimi Administrativ përfshin (a) sektorët e rrezikshëm dhe (b) aktivitetet e përgjithshme të rrezikshme që duhet të ndalohen me prioritet. Në vitin 2013, UA 17/2008 u zëvendësua me Udhëzimin Administrativ QRK Nr. 05/2013 për Parandalimin dhe eliminimin e punëve të rrezikshme për fëmijë në

Kosovë , duke përditësuar listën e punëve të rrezikshme për fëmijë.

Aktivitetet e përgjithshme të rrezikshme (që vlejnë për çdo sektor) përfshijnë:

- punën gjatë natës (ndërmjet orës 20:00 dhe 6:00;
- ngritjen dhe bartjen e kohëpaskohshme të peshave të rënda mbi 15 kg (M) dhe 10 kg (F);
- ngritjen dhe bartjen e vazhdueshme të peshave mbi 10 kg (M) dhe 5 kg (F);
- punën në thellësi, në sipërfaqe të tokës, në ujë dhe vende të mbyllura;
- punën në lartësi mbi 2 m;
- punën që mund të shkaktojë dëme në shëndetin e fëmijës për shkak të ekspozimit ndaj temperaturave ekstreme të larta apo të ulëta, ose ndaj zhurmës dhe dridhjes;
- ekspozimin ndaj substancave biologjike, kimike dhe toksike² dhe ekspozimin ndaj radioaktivitetit.

Sektorët për ndalim të menjëhershëm përfshijnë:

- Bujqësinë dhe pylltarinë
- Ndërtimtarinë
- Eksploatimin e pasurive natyrore
- Punën në rrugë
- Punën në deponi të mbeturinave

Meqenëse angazhimi i fëmijëve në punët e shtëpisë nuk është i rregulluar në Kosovë, përkufizimet e Treguesit 2 për matjen e punës së fëmijëve me qëllim të raportimit për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ-së)³, mund të aplikohen (krahas UA 05/2013) për identifikimin e fëmijëve të përfshirë në punën e fëmijëve, vlerësimin e rrezikut, si dhe në raportimin për OZHQ-të. Ky tregues i referohet përqindjes dhe numrit të fëmijëve të moshës 5-17 vjeç të angazhuar në aktivitete ekonomike dhe punët e shtëpisë në ose mbi pragjet e orarit specifik për moshën (mbi kufirin e prodhimit të përgjithshëm):

- Puna e fëmijëve për grupmoshën 5 deri në 11 vjeç: fëmijët që punojnë së paku 1 orë në javë në aktivitet ekonomik dhe/ose janë të përfshirë në shërbime shtëpiake të papaguara për më shumë se 21 orë në javë;
- Puna e fëmijëve për grupmoshën 12 deri në 14 vjeç: fëmijë që punojnë për të paktën 14 orë në javë në aktivitet ekonomik dhe/ose janë të përfshirë në shërbime shtëpiake të papaguara për më shumë se 21 orë në javë;
- Puna e fëmijëve për grupmoshën 15 deri në 17 vjeç: fëmijët që punojnë për më shumë se 43 orë në javë në aktivitet ekonomik⁴.

² Lista e detajuar e substancave biologjike, kimike dhe toksike është poashtu e përcaktuar

³ Konferenca e 20-të Ndërkombëtare e Statistikave të Punës. Rezoluta për të ndryshuar Rezolutën e 18-të të ICLS në lidhje me statistikat e punës së fëmijëve. ILO. Gjenevë, Tetor 2019

⁴ Për moshat 15-17 vjeç nuk ka limit të përcaktuar për punët shtëpiake.

1.2 Pasojat e punës së fëmijëve

Puna e fëmijëve ndikon në zhvillimin e fëmijëve sa i përket shëndetit, arsimit, moralit dhe mirëqenies psikologjike. Ajo gjithashtu prek familjen dhe shoqërinë.

Ndikimi te fëmija

Më poshtë janë efektet kryesore të formave të ndryshme të punës, nga perspektiva shëndetësore dhe e sigurisë⁵:

- Lëndimet fizike dhe gjymtimet shkaktohen nga makineri të mirëmbajtura dobët në ferma dhe fabrika, aksidente me hanxhar në plantacione dhe një numër rreziqesh që hasen në industri të tilla si minierat, përpunimi i drurit dhe prodhimi.
- Helmimet nga pesticidet janë një nga vrasësit më të mëdhenj të punëtorëve fëmijë në sektorin e bujqësisë, në të gjithë botën.
- Mangësia e rritjes është e përhapur te fëmijët që punojnë, të cilët kanë tendencë të jenë më të shkurtër dhe me peshë më të ulët se fëmijët e tjerë; këto mangësi ndikojnë edhe në jetën e tyre si të rritur.
- Problemet shëndetësore afatgjata, të tilla si sëmundjet e frymëmarrjes, asbestoza dhe një sërë kanceresh, janë të zakonshme në vendet ku fëmijët detyrohen të punojnë me kimikate të rrezikshme.
- Rraskapitja dhe kequshqyerja janë rezultat i fëmijëve të pazhvilluar që kryejnë punë të rëndë fizike, duke punuar orë të gjata në kushte të padurueshme dhe duke mos fituar mjaftueshëm për të ushqyer veten e tyre në mënyrë adekuate.

Puna e fëmijëve mund të ketë një ndikim negativ edhe në zhvillimin mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror të fëmijës për shkak të:

- paaftësisë së fëmijëve në punë për të ndjekur shkollën normalisht; qoftë sepse nuk i ndjekin mësimet ose sepse janë shumë të lodhur për t'u përqendruar në mësim, fëmijët në punë nuk ndjekin një arsimim normal;
- thyerjes së rrjeteve sociale (fëmijët që punojnë nuk kanë kohë për të parë miqtë e tyre) pasi mungesa e tyre në shkollë gjithashtu i pengon ata që të shoqërohen me bashkëmoshatarët e tyre;
- aktiviteteve jo-stimuluese, monotone që kanë ndikim negativ në krijimtarinë/fleksibilitetin e ardhshëm të fëmijëve; tregtia dhe aktivitetet që fëmijët në punë do të mësojnë nga «përvoja» do të jenë specifike dhe me aftësi të ulëta. Kjo nuk do të lejojë që fëmija të fitojë fleksibilitetin dhe aftësitë e nevojshme për të përfituar nga mundësitë në jetën e tij/saj prej të rrituri.
- të gjitha llojeve të keqtrajtimit, përfshirë pakujdesinë, trajtimin jo-konsistent dhe të ashpër, abuzimin emocional dhe shtrëngimin.

⁵ Fondacioni ECLT, 2005 gjendet në: <http://www.eclt.org/about/overvieë.htm>

► Kujdes!

Përshkrimi i hollësishëm i rreziqeve specifike në kuadër të aktiviteteve të ndaluara në sektorin e bujqësisë dhe pylltarisë dhe ndikimit të tyre të mundshëm te fëmijët është dhënë në Kapitullin 3.

Ndikimi në familje

Në planin afatshkurtër, puna e fëmijëve rrit të ardhurat e familjeve dhe shanset e mbijetesës, por në planin afatgjatë, puna e fëmijëve përjetëson varfërinë familjare përmes kapitalit më të ulët njerëzor, pasi puna e fëmijëve nuk çon në zhvillimin e aftësive.

Ndikimi në shoqëri

Puna e fëmijëve mund të ngadalësojë rritjen dhe zhvillimin shoqëror përmes zvogëlimit të akumulimit të kapitalit njerëzor. Nëse fëmijët në fakt zëvendësojnë punëtorët e rritur duke krijuar papunësi te të rriturit dhe/ose ulje të pagave të të rriturve mbetet një pyetje e hapur; por në atë masë që fëmijët konkurrojnë me të rritur të pakualifikuar për punë të njëjta, fëmijët në punë ndikojnë në punësimin e të rriturve ose në pagat e të rriturve në varësi të strukturës së tregut të punës.

▶ 2

Konteksti i punës së
rrezikshme të fëmijëve
në bujqësi dhe pylltari



2.1 Sektori i bujqësisë

Bujqësia është njëra nga shtyllat më të rëndësishme të ekonomisë së Kosovës; ajo kontribuon në Bruto Produktin Vendor (BPV) me rreth 10 %, ndërsa punëson afërsisht 25-35% të numrit të përgjithshëm të të punësuarve. Duke marrë për bazë kontributin e sektorit në BPV dhe në punësim, bujqësia konsiderohet të jetë gjithashtu burim i rëndësishëm i të ardhurave për banorët e zonave rurale që përbëjnë rreth 60% të popullsisë. Bazuar në rezultatet e Regjistrimit të Bujqësisë 2014, numri i njërive bujqësore ishte 130,775 ndërsa numri i të punësuarve me punë të rregullt në bujqësi ishte 86.620 (MBPZHR, 2016).

Edhe pse vitet e fundit vërehet tendencë e përmirësimit, bujqësia në Kosovë ende karakterizohet nga ferma të vogla, produktivitet i ulët, nivel i ulët i aplikimit të teknologjive të reja, mekanizim i vjetruar, marketing i dobët, konkurrenca nga vendet për rreth dhe probleme tjera që lidhen me përshtatjen e kësaj prodhimtarie kërkesave të tregut gjithnjë e më shumë në rritje. Shumica e fermave janë aktivitete bujqësore të mbijetesës, duke prodhuar kryesisht për vetë-konsum.

Ky nivel i ulët i zhvillimit të bujqësisë, zakonisht kërkon përfshirje më të madhe të fuqisë punëtore, që do të thotë edhe rrezik më i madh për përfshirjen e fëmijëve në punë të rrezikshme në bujqësi. Rrjedhimisht, zhvillimi dhe modernizimi i këtij sektori, përveç tjerash, do ta zvogëlonte edhe nevojën për përfshirje të fëmijëve në punët e rrezikshme në bujqësi.

Bazuar në kushtet natyrore, në traditën dhe mundësitë për ndërtimin e konkurrencës, është e nevojshme që sektorët të cilët do të kenë përparësi, siq është sektori i perimeve dhe pemëve të përkrashen në mënyrë të veçantë. Këta sektorë paraqiten mjaft të rëndësishëm, në rend të parë për substituimin e importit, pasi që sasi e madhe e këtyre produkteve importohet nga vende të ndryshme (kryesisht nga vendet fqinje). Zhvillimi i sektorit të hortikulturës do të ishte shtytës mjaft i rëndësishëm edhe për zhvillimin e industrisë përpunuese (pasi që shumica e produkteve të përpunuara në këta sektorë gjithashtu importohen).

Për më tepër, në dokumentet strategjike të MBPZHR-së, adresimi i punës së rrezikshme të fëmijëve po zë vend gjithnjë e më të madh, por është shumë e rëndësishme që ky fenomen të adresohet qartë në mënyrë që krahas masave për promovim të bujqësisë dhe pylltarisë mos të inkurajohet (tërthorazi) edhe puna e fëmijëve në këta sektorë.

2.2 Situata dhe shkaqet e punës së fëmijëve në sektorin e bujqësisë dhe pylltarisë

Bujqësia mbetet sektori në të cilin puna e fëmijëve, edhe në nivel global, është më së shumti e shprehur; mbi 70% e fëmijëve të përfshirë në punë apo 112 milionë fëmijë në mbarë botën⁶. Situata e pa favorshme socio-ekonomike dhe niveli i ulët i të ardhurave janë faktorë që mund të nxisin përfshirjen e fëmijëve në punë të ndryshme. Punëdhënësit mund të preferojnë të punësojnë fëmijë sepse mund ti kontraktojnë më lirë se të rriturit e tyre homologë⁷. Puna e fëmijëve ndikohet gjithashtu nga praktikat kulturore, pabarazitë sociale dhe gjinore dhe mungesa e ndërgjegjësimit të komuniteteve për pasojat e saj negative.

⁶ Child labour, Global estimates 2020, Trends and the road forward, International Labour Organization and United Nations Children's Fund, 2021 gjendet në: https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed_norm/---ipecc/documents/publication/wcms_797515.pdf

⁷ Handbook for monitoring and evaluation of child labour in agriculture, Food and Agriculture Organization of the United Nations, Rome 2015 gjendet në: https://www.fao.org/3/i4630e/i4630e.pdf?utm_source=visiting+cards&utm_medium=qr-code&utm_campaign=occ-book-cards

Ngjashëm me sektorët tjerë të punës së fëmijëve, varfëria dhe pabarazitë janë nxitësit kryesorë të punës së fëmijëve edhe në sektorin e bujqësisë. Zbatimi joadekuat i kuadrit ekzistues ligjor e përkeqëson më tej situatën, ndërsa faktorët tjerë që ndikojnë në angazhimin e fëmijëve në aktivitete të rrezikshme bujqësore përfshijnë: qasjen e kufizuar në arsim cilësor, infrastrukturën e dobët në zona rurale, mungesën e mbrojtjes sociale, të ardhurat e ulëta nga të korrat, teknologjinë apo praktikat e joadekuata bujqësore, mungesën e burimeve për të angazhuar punëtorë me pagesë, fuqizimin e dobët të grave dhe qëndrimet tradicionale ndaj pjesëmarrjes së plotë të fëmijëve në aktivitetet bujqësore. Kërkesat për fuqi të lirë punëtore nga njëra anë, dhe mungesa e fuqisë së lirë punëtore për punët sezonale në bujqësi nga ana tjetër, poashtu krijojnë rrethana të favorshme për angazhimin e fëmijëve në punë të ndryshme bujqësore.

Sipas të dhënave të Raportit të gjetjeve të Anketës së Treguesve të Shumëfishtë në Kosovë, 6.3% e fëmijëve janë të përfshirë në punë të fëmijëve⁸, ndërsa jetesa në zonat rurale është ndër faktorët që rrisin gjatë të përfshirjes në punë të fëmijëve⁹. Rreziqet më të rëndomta të cilave u ekspozohen fëmijët janë: ekspozimi ndaj temperaturave ekstreme, lagështisë, pluhurit dhe gazrave. Poashtu, sipas të dhënave anekdotike nga një seri takimesh direkte me fermer (përfutjes të subvencioneve dhe granteve të MBPZHR), të realizuara në vitin 2012 nga Njësia për të Drejta të Njeriut dhe Mbrojtje nga Diskriminimi në MBPZHR¹⁰, angazhimi i fëmijëve në aktivitete bujqësore, përfshirë ato të rrezikshme, fillon kryesisht nga mosha 11 ose 12 vjeçare¹¹. Në këto aktivitete janë të përfshirë kryesisht djemt, me përjashtim të angazhimit në mbjellje dhe vjelje të frutave dhe perimeve, grumbullim dhe rrotullim të barit dhe pjesërisht edhe në spërkatje me pesticide ku janë të përfshira edhe vajzat.

Në tabelën vijuese është dhënë një pasqyrë e aktiviteteve të rrezikshme në sektorin e bujqësisë dhe pylltarisë në të cilat janë të përfshirë fëmijët, sipas regjioneve.

8 Anketa e grupimeve të treguesve të shumëfishtë 2019-2020 për Republikën e Kosovës dhe Anketa e grupimeve të treguesve të shumëfishtë 2019-2020 për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës, Raporti i gjetjeve të anketës, Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe UNICEF, 2020 gjendet në: https://ask.rks-gov.net/media/5765/republic-of-kosovo-national-and-roma-ashkali-and-egyptian-communities-2019-20-mics-sfr_albanian.pdf

9 Faktorët e ndërlidhur me rritjen e probabilitetit për përfshirje në punë të fëmijëve:

- Mosha (në mënyrë jolineare)
- Gjinia (mashkullore)
- Jetesa në zonë rurale
- Mungesa e prindit biologjik

10 Takimet janë organizuar në bashkëpunim me Departamentin e Shërbimeve Këshillimore dhe me Zyrat Regjionale të MBPZHR, ndërsa me mbështetje teknike dhe financiare nga ONP.

11 Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në këto konsultime ishte 159, prej të cilëve: 103 fermer (21 në regjionin e Pejës, 17 në regjionin e Gjilanit, 19 në regjionin e Prizrenit, 28 në regjionin e Mitrovicës, 9 në regjionin e Ferizajit dhe 9 në regjionin e Prishtinës), 39 përfaqësues të Drejtorive Komunale të Bujqësisë (4 në regjionin e Pejës, 8 në regjionin e Gjilanit, 4 në regjionin e Prizrenit, 10 në regjionin e Ferizajit dhe 13 në regjionin e Prishtinës), 17 përfaqësues të Zyrave Regjionale të MBPZHR (3 në Regjionin e Pejës, 4 në Regjionin e Gjilanit, 3 në Regjionin e Prizrenit, 2 në Regjionin e Mitrovicës, 3 në Regjionin e Ferizajit dhe 2 në Regjionin e Prishtinës).

Tabela 2. Aktivitetet e rrezikshme bujqësore që kryhen nga fëmijët sipas regjioneve

Aktivitetet e rrezikshme bujqësore që kryhen nga fëmijët sipas regjioneve					
Prishtinë	Pejë	Gjilan	Ferizaj	Mitrovicë	Prizren
● Punë në korrje-shirje	● Punë me pesticide	● Punë me pesticide	● Ruajtja e bagëtisë;	● Punë me pesticide	● Punë me pesticide
● Punë me pesticide	● Punë me makineri bujqësore	● Punë me makineri bujqësore	● Operimi me makineri bujqësore;	● Punë me makineri bujqësore	● Punë me makineri bujqësore
● Punë me makineri bujqësore (kosë rrotulluese, motokultivator, traktor dhe makina kositëse)	● Punë në korrje-shirje	● Punë në korrje-shirje	● Punë me pesticide	● Punë në korrje-shirje	● Punë në korrje-shirje
● Vjelja e frutave të pyllit	● Prerja dhe përpunimi i drurit	● Pastrimi i barishtave dhe vjelja e perimeve në sera	● Punë në korrje-shirje	● Prerja e drunjëve	● Prerja e drunjëve
● Shkarkimi i farërave (ngritja e peshave të rënda)	● Vjelja e frutave të pyllit	● Vjelja dhe paketimi i frutave dhe perimeve për kohë të zgjatur	● Prerja dhe përpunimi i drurit	● Ruajtja e bagëtisë në terrene të papërshtatshme	● Ruajtja e bagëtisë në terrene të papërshtatshme
● Mbushja dhe bartja e rezervoarve të ujit (në mënyrë mekanike buzë lumenjëve dhe liqeneve) në distanca të largëta	● Vjelja dhe paketimi i frutave dhe perimeve për kohë të zgjatur	● Ruajtja e bagëtisë në terrene të papërshtatshme		● Pastrimi i shtallave	● Pastrimi i shtallave
● Pastrimi i shtallave		● Pastrimi i shtallave		● Pastrimi i barishtave dhe vjelja e perimeve në sera	● Vjelja dhe paketimi i frutave dhe perimeve për kohë të zgjatur
				● Vjelja e frutave të pyllit pa përkujdesje të të rriturve	● Rrotullimi dhe grumbullimi i barit

Disa specifika regjionale sa i përket angazhimit të fëmijëve në aktivitete të rrezikshme bujqësore përfshijnë si vijon:





- në Regjionin e Pejës, fëmijët janë më së shumti të angazhuar në pylltari (prerja, bartja) si dhe në përdorimin e mekanizmit bujqësor;
- Regjionin e Prizrenit e karakterizon angazhimi i fëmijëve në vreshta dhe serra, në përdorimin e mjeteve kimike (pesticide dhe herbicide), bartjen e peshave të rënda (sidomos në periudhën e korrje -shirjeve), si dhe përdorimin e mekanizmit bujqësor;
- në Regjionin e Prishtinës, për shkak të mungesës së ujit të pijës fëmijët janë të rrezikuar gjatë mbushjes së rezervoarve të ujit si për shfrytëzim nga familja ashtu edhe për kafshë;
- në komunat të cilat janë në vijë kufitare me shtetet fqinje, fëmijët shfrytëzohen edhe për kontrabandimin e kafshëve.

Në bazë të deklarimeve të fermerëve, shkaqet e angazhimit

- Mungesa e vetëdijes për rreziqet dhe pasojat e angazhimit të fëmijëve në aktivitetet e caktuara bujqësore;
- Kushtet e vështira ekonomike të familjeve që pamundësojnë angazhimin e punëtorëve me pagesë;
- Mungesa e makinerisë bujqësore që do të mund të zëvendësonte angazhimin e fëmijëve në disa aktivitete të rrezikshme;
- Natyra familjare e aktiviteteve bujqësore, që nënkupton angazhimin e të gjithë anëtarëve të rritur në familje dhe rrjedhimisht domosdoshmërinë që fëmijët të jenë pranë tyre (që të mos lihen në shtëpi pa përkujdesje);
- Mungesa e programeve të edukimit jo-formal (p.sh. kurse dhe aktivitete të tjera edukative), aktiviteteve sportive e rekreative apo forma tjera të aktiviteteve të organizuara për fëmijë si mundësi e angazhimit të fëmijëve jashtë shkolle;
- Parcializimi i tokave dhe mungesa e organizimit të fermerëve në nivel fshati apo edhe më gjerë;
- Mungesa e mbikqyrjes së plotë të aktiviteteve që zhvillohen nga fermerët, përfshirë kushtet e punës dhe profilin e punëtorëve të përfshirë për realizimin e punëve

▶ 3

Çka duhet të dijnë
fermerët?



Bujqësia dhe pylltaria hyjnë në kategorinë e sektorëve të rrezikshëm punues; nga dhjetë profesionet më të rrezikshme, katër prej tyre kanë të bëjnë me bujqësinë dhe pylltarinë¹². Fermerët në vazhdimësi i ekspozohen rreziqeve të ndryshme gjatë punës së tyre të përditshme. Pasojat e këtyre rreziqeve mund të jenë direkte dhe indirekte, të menjëhershme dhe afatgjata.

Përmes Udhëzimit Administrativ QRK Nr. 05/2013 për Parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijëve në Kosovë, janë listuar punët e rrezikshme për fëmijë që kërkojnë ndalim të menjëhershëm. Punët e rrezikshme dhe të ndaluara për fëmijë në sektorin e bujqësisë dhe pylltarisë janë listuar në tabelën vijuese¹³.

Tabela 3: Aktivitetet e rrezikshme për fëmijë në sektorin e bujqësisë dhe pylltarisë

Aktivitetet	Rreziqet
Puna në ujitje me sistem pompimi, kur burim i ujit janë puset dhe burimet tjera.	Rryma, uji i ftohte, infektimi, peshat e rënda.
Operimi me makina bujqësore dhe mekanizëm bujqësor bashkëngjijtjes dhe përcjellës	Rrëzimi nga makina në lëvizje, ndeshja me objekte të tjera, aksidentimi i të tjerëve.
Puna me pesticide dhe spërkatja.	Helmimi me pesticide, djegiet kimike.
Puna në korrje, shirje dhe kositje.	Kontakti/thithja e pluhurit organik, kontaktet me alergjen, prerjet.
Puna me vegla bujqësore dhe hapja e gropave për mbjellje të pemëve.	Ngarkesa e madhe fizike dhe mendore, ekspozimi ndaj kushteve ekstreme atmosferike, orët e zgjatura të punës, prerjet.
Puna në serrë.	Temperaturat e larta, mbetjet e pesticideve, gazrat helmuese.
Punët silvi-kulturore në pyje, pyllëzime dhe mbrojtje nga zjarri dhe sëmundjet.	Përdorimi i mjeteve të mprehta, mbajtja dhe bartja e peshave të rënda, lëvizjet e përsëritura, qëndrimi në pozita jo të përshtatshme gjatë operimit, përfshirja nga zjarri pyjor.
Shfrytëzimi i masës drusore në pyje dhe përpunimi primar i drurit	Përdorimi i mjeteve të mprehta dhe të rrezikshme për prerjen e drunjëve (motosharra, sëpata, pyka, etj). Rrëzimi i trungjeve, degëve të thata. Orari i zgjatur i punës. Ekspozimi ndaj kushteve të pa përshtatshme atmosferike. Terrenet e pa përshtatshme. Manipulimi me makineri bujqësore (traktor, kamion).
Puna në thertore dhe në industrinë e përpunimit të mishit.	Rreziku nga kafshët që theren Mjetet që përdoren për therje. Kontakti me agens biologjik dhe kimik. Bartja e peshave të rënda. Trauma psikologjike.

¹² Zyra Amerikane e Statistikave të Punës ka llogaritur shkallën e vdekshmërisë në kuadër të një profesioni, duke marrë për bazë numrin e vdekjeve për 100 mijë punëtorë me orar të plotë pune.

¹³ UA aktualisht është në rishikim dhe tabela në vijim përmban listën e përditësuar të aktiviteteve për ndalim të menjëhershëm në sektorin e bujqësisë

Aktivitetet	Rreziqet
Angazhimi në aktivitete të gjuetisë dhe peshkimit.	Rreziku nga plagosjet, vrasjet, etj. Përdorimi i rrymës dhe dinamitit për peshkim.
Grumbullimi i produkteve jo-drusore në pyje.	Terreni i papërshtatshëm, kafshimi nga gjarpërinjtë.
Aktivitetet në gjueti dhe kultivim të kafshëve të egra.	Armët, kurthet, sulmet nga kafshët e egra, bartja e sëmundjeve nga kafshëve të egra.

Tek shumë fëmijë që punojnë në ferma, rreziku i aksidenteve dhe sëmundjeve është evident duke përfshirë edhe ekspozimin ndaj pesticideve dhe materieve tjera kimike që përdoren shpesh në bujqësi. Ata janë në rrezik nga një shumëllojshmëri e gjerë e rreziqeve në punë.

Edhe pse ndryshimi teknologjik ka sjellë një reduktim të punës fizike në bujqësi, ky ndryshim shoqërohet nga rreziqe të reja që lidhen me përdorimin më të sofistikuar të makinerive dhe përdorimin intensiv të kimikateve, veçanërisht pesticideve. Masat e sigurisë dhe shëndetit, informacioni dhe trajnimi jo i duhur, terreni i vështirë dhe ekspozimi ndaj substancave të rrezikshme, i kombinuar me lodhjen dhe, shpesh, kequshqyerjen, rrisin rrezikun e aksidenteve. Nivelet e aksidenteve dhe sëmundjeve fatale dhe të rënda janë të larta¹⁴.

► **Kujdes!**

Pasojat e përfshirjes së fëmijëve në punët e rrezikshme në bujqësi, mund të kenë efekte afatgjate për shëndetin e fëmijëve. Çdo dëmtim në këtë fazë ka pasojat afatgjate për shëndetin e tyre.

Faktorë të tjerë që rrisin nivelet e rrezikut për fëmijë përfshijnë¹⁵:

- mungesa e përvojës së punës – fëmijët nuk janë në gjendje të bëjnë gjykime të informuara;
- dëshira për të performuar mirë
- të mësuarit e sjelljeve të pasigurta për shëndetin dhe sigurinë nga të rriturit;
- mungesa e trajnimit për sigurinë dhe shëndetin në punë;
- mbikëqyrje joadekuate, madje e ashpër;
- mungesa e fuqisë për organizim dhe realizim të të drejtave në punë.

¹⁴ Child labour prevention in agriculture. Junior Farmer Field and Life School - Facilitator's guide, FAO, Rome 2010 gjendet në: <https://www.fao.org/3/i1897e/i1897e.pdf>

¹⁵ Child labour prevention in agriculture. Junior Farmer Field and Life School - Facilitator's guide, FAO, Rome 2010 gjendet në: <https://www.fao.org/3/i1897e/i1897e.pdf>

Një problem tjetër që indirekt dëmton shëndetin e fëmijëve është orari i gjatë i punës i cili është shumë i zakonshëm në punët e fermës. Në qoftë se kësaj i shtojmë edhe kohën që kalohet prej dhe deri në vend të punës, atëherë e shohim se fëmijët që janë të përfshirë në punë e kanë të vështirë ta ndjekin mësimin.

► **Kujdes!**

Përvec angazhimit në punë, rrezik mund të paraqes edhe qëndrimi i fëmijës në zona të caktuara, prandaj është me rëndësi vendosja e shenjave të kujdesit, që i njoftojnë fëmijët për rreziqet që mund të ju kanosen.

Këto shenja duhet të vendosen sidomos në zonat ku punohet me pesticide, vendet ku përgatiten apo ruhen pesticidet, zonat ku janë në përdorim makinat e ndryshme bujqësore, në hyrje të thertoresh së kafshëve apo në zonat ku përpunohet mishi dhe produktet e tij.

3.1 Cilat aktivitete bujqësore janë të ndaluara për fëmijët dhe pse?

Në secilën veprimari bujqësore ekzistojnë aktivitete të caktuara që nuk duhen kryer nga fëmijët, prandaj të gjithë fermerët duhet të jenë në dijeni për to dhe për ndikimin e tyre në shëndetin dhe zhvillimin e fëmijës. Me idenë që këto çështje të trajtohen me fermerë në kuadër të trajnimeve dhe konsultimeve direkte që do të zhvillohen me ta mbi veprimtaritë e ndryshme bujqësore, materiali në vijim është organizuar sipas temave të parapara nga ana e MBPZhR-së, për trajnimin dhe këshillimin e fermerëve. Për secilën veprimtari bujqësore janë listuar aktivitetet e rrezikshme që nuk duhen kryer nga fëmijët, rreziqet e ndërlidhura me to dhe ndikimi potencial i këtyre rreziqeve në shëndetin dhe zhvillimin e fëmijës.

3.1.1 Aktivitetet e ndaluara për fëmijë në blegtori

Punët e fëmijëve në blegtori mund të jenë të ndryshme, nga më të thjeshtat deri te situatat e formave më të rrezikshme të punës së fëmijëve.

► **Kujdes!**

Fëmijët nuk duhet të futen vetëm në stallë pa shoqërimin e prindërve apo punëtorëve që janë të angazhuar në stalla.

Disa nga punët kryesore që fëmijët kryejnë në ferma të blegtorisë janë:

- përgatitja e ushqimit voluminoz (sanës dhe sillazhës) dhe ushqimit të koncentruar (bluarjes së drithërave dhe përgatitjes së mekanizuar të racioneve) për bagëti,
- kujdesi për punët tjera ndihmëse: largimi i plehut, ngarkim/shkarkimi i ushqimit voluminoz, lëshimi dhe kthimi i kafshëve në stallë nga kullota, transporti dhe ngarkim/shkarkimi i bagëtive gjatë transportit, asistimi gjatë përkujdesjes dhe trajtimit veteriner, si dhe
- pastrimi dhe dezinfektimi i mjeteve të punës, objektit të stallës, infrastrukturës përcjellëse të fermës dhe mjedisit të fermës.

Në këto raste fëmijët i ekspozohen rrezikut të infektimit nga sëmundjet infektive që transmetohen nga kafshët (zoonozat), preparatet kimike dhe lëndimet nga kafshët. Përveç këtij rreziku fëmijët janë të rrezikuar edhe nga makineritë e ndryshme që përdoren në ferma apo nga pajisjet e ndryshme që përdoren për të ju shërbyer kafshëve shtëpiake.

Gjatë ndërtimit të stallave, me qëllim që të parandalohen aksidentet apo lëndimet, duhet pasur kujdes që ato t'i përmbahen standardeve zooteknike dhe zoohigjienike, sipas llojit të kafshës dhe kërkesave fiziologjike të tyre, duke përfshirë edhe:

- ndriçimin e mjaftueshëm,
- dyshemënë e parrëshqitshme dhe
- pjerrtësinë e lehtë të dyshemesë që largon shpejt urinën e kafshëve.

► **Kujdes!**

Në stalla ka shumë burime të ndotjes së ajrit (amoniaku, dioksidi i karbonit e gazra tjerë), të cilët mund të ndikojnë mjaft keq në shëndetin e njeriut duke shkaktuar ndjenjë të keqe dhe dhembje koke përmes depërtimit të tyre në rroba, flokë e lëkurë. Andaj është shumë e nevojshme që fëmijët mos të futen në këto stalla nëse ato nuk janë të ajrosura.

Në tabelën vijuese janë dhënë aktivitetet e rrezikshme dhe të ndaluara për fëmijë në fushën e blegtorisë.

Aktiviteti	Rreziku	Efektet në shëndetin e fëmijëve
Përkujdesi për kafshët në stallë (mjelja, të ushqyerit, largimi i plehut).	Rrëshqitja në stallë kur ajo nuk është e pastruar mirë. Bartja e peshave të rënda. Ekspozimi ndaj gazrave që lirohen gjatë zbërthimit të plehrave organike.	Lëndimet nga rrëshqitja. Lodhja, dhembjet dhe lëndimet e muskujve, nyjeve dhe organeve tjera. Deformimet trupore. Infektimi apo helmimi nga plehërat organike. Dëmtimi i organeve të frymëmarrjes.
Manipulimi me ushqime të ndryshme të koncentruara.	Koncentratet e ndryshme për ushqimin e kafshëve. Peshat e rënda.	Alergjia. Deformime trupore. Dhembje e nyjeve dhe muskujve.
Pastrimi i veglave të punës që përdoren në stalla.	Mjetet e mprehta ose të rënda.	Lëndimet fizike.
Aktivitetet për kujdesin e kafshëve në kullota .	Ekspozimi për një kohë të gjatë ndaj kushteve të pa përshtatshme klimatike. Mungesa apo qasja e pamjaftueshme në ujë të pijes. Ekspozimi ndaj kafshëve të egra, gjarpërinjëve, insekteve. Terrenet e pa përshtatshme.	Dehidratimi. Dëmtime nga konsumimi i ujit jo të përshtatshëm për pije. Lëndimet, deri në fatalitet, nga aksidentet e mundshme për shkak të terrenit të papërshtatshëm. Trauma nga frika permanente prej kafshëve të egra. Sulmet nga kafshët e egra, kafshimi nga gjarpërinjtë, pickimet nga insektet e ndryshme. Plagë të ndryshme nga gjembat, nga rrëshqitja, nga rrugët vështirë të kalueshme.
Cdo aktivitet në therrtore	Përdorimi i mjeteve të mprehta. Ekspozimi ndaj kafshëve të therrura.	Trauma nga procesi i therrjes së kafshëve. Lëndimet e ndryshme me mjete të mprehta.

Përveç këtyre rreziqeve duhet pasë kujdes edhe nga lëndimet fizike që mund t' u shkaktohen fëmijëve nga kafshët e moshës së re, të cilat janë shumë më dinamike (psh. në asnjë mënyrë nuk duhet lejuar që të ju afrohen demave të moshës 12 deri 14 muaj)¹⁶.

Fëmijët poashtu nuk duhet lejuar të qëndrojnë afër kafshëve të posalindura, nuk duhet të jenë të pranishëm kur kafshët janë duke u lëshuar nga stallat (pas një periudhe strehimi) ose kur kafshët janë duke u ngarkuar në rimorkio.

3.1.2 Aktivitetet e ndaluara për fëmijë në pentari dhe vreshtari

Aktivitetet e rrezikshme për fëmijë në fushën e pentarisë dhe vreshtarisë janë përmbledhur në tabelën vijuese. Krahas tyre janë listuar edhe rreziqet potenciale dhe efekti i tyre në shëndetin dhe zhvillimin e fëmijës.

Aktiviteti	Rreziku	Efektet në shëndetin e fëmijëve
Përgatitja së tokës për ngritjen e pemishteve.	Përdorimi i mjeteve të rënda të punës. Orari i gjatë i punës. Ekspozimi i gjatë ndaj zhurmës.	Lëndimet e ndryshme. Lodhja e madhe dhe dhembja e muskujve dhe nyjeve. Dobësim i dëgjimit.
Spërkatja e pemëve (gjatë përdorimit të pesticideve)	Ekspozimi ndaj pesticideve dhe materjeve tjera toksike.	Helmimet akute me pesticide dhe efektet e tyre afatgjate në shëndetin e fëmijëve (problemet respiratorë, neurologjike deri te kancerogjene).
Aplikimi i plehrave minerale.	Ekspozimi ndaj materieve toksike që përmbajnë plehrat e ndryshëm. Bartja e peshave të rënda. Orari i gjatë i punës. Kushtet e papërshtatshme atmosferike.	Helmimet. Lodhja dhe dhembjet e muskujve dhe nyjeve. Deformimet trupore. Irritimi i lëkurës, crregullimet diarreike, të vjellat, dehidrimi, e deri te goditja nga dielli.

¹⁶ Smjernica dobre prakse: Rizici u poljoprivredu, Hrvatski zavod za zastitu zdravlja i sigurnost na radu, Zagreb, 2015 gjendet në: <http://www.hzzsr.hr/wp-content/uploads/2016/11/Smjernica-za-siguran-rad-u-poljoprivredi.pdf>

Aktivitete	Rreziku	Efektet në shëndetin e fëmijëve
Përdorimi i makinave për mirëmbajtjen e tokës në pemishte gjatë vegjetacionit.	Rreziku potencial për aksidente (sidomos në terene të pa përshtatshme)	Lodhje, lëndime (pasi që këto makina janë zakonisht të rënda për të operuar me to fëmijët). Dëmtimet e ndryshme si rezultat i dridhjeve, dhe zhurmës së krijuar nga makinat.
Përdorimi i pompave apo puseve për ujitje	Energjia elektrike. Puset dhe kanalet.	Lëndime fizike nga pompat me energji elektrike. Lëndimet deri te mbytja në puse apo kanale që përdoren për ujitje.
Puna në krasitje dhe vjelje	Shkallët. Puna në lartësi. Mjetet e krasitjes. Orari i gjatë i punës. Mbajtja e trupit në pozitë jo të përshtatshme. Ekspozimi ndaj kushteve të papërshtatshme atmosferike.	
Përdorimi i pompave apo puseve për ujitje	Peshat e rënda. Orari i gjatë i punës.	Lodhja dhe dhembjet e muskujve dhe nyjeve. Deformimet trupore.

3.1.3 Aktivitetet e ndaluara për fëmijë në perimekulturë me lavërtari

Fëmijët janë të përfshirë në çdo fazë të prodhimit bimor: nga përgatitja e tokës, mbjellja dhe pastrimi i barërave të këqija, deri në korrje dhe përpunim. Por, prodhimi bimor nënkupton rreziqe të ndryshme tipike dhe serioze për fëmijët¹⁷.

Puna në fusha është poashtu edhe punë e rëndë fizike, si p.sh. kositja (kur bëhet me kosë dore) dhe mihja e bimëve në mes rendeve. Kjo mund të shkaktoj ngarkesë të madhe fizike, ekspozim për kohë të gjatë kushteve të pa përshtatshme atmosferike, si rezultat i orarit të gjatë të punës.

¹⁷ Handbook for monitoring and evaluation of child labour in agriculture, Food and Agriculture Organization of the United Nations, Rome 2015 gjendet në: https://www.fao.org/3/i4630e/i4630e.pdf?utm_source=visiting+cards&utm_medium=qr-code&utm_campaign=occ-book-cards

Aktivitetet që kërkojnë kujdes të shtuar të fermerëve në kuadër të perimekulturës me lavërtari janë listuar në tabelën vijuese.

Aktiviteti	Rreziku	Efektet në shëndetin e fëmijëve
Përgatitja e tokës për mbjellje.	Përdorimi i makinave të rënda. Orari i gjatë. Ekspozimi ndaj zhurmës..	Lëndimet me makina, deri në fatalitet, nga aksidentet potenciale. Lodhje e madhe dhe deformime trupore. Dobësim i dëgjimit..
Masat e përkujdesit gjatë vegjetacionit.	Orari i gjatë në fushë. Përdorimi i mjeteve të ndryshme të punës për këto masa të përkujdesit.	Dëmtime të ndryshme si rezultat i ekspozimit për kohë të gjatë kushteve të pa favorshme klimatike (temperaturave të larta, ftohtit). Lëndime të ndryshme nga mjetet e punës dhe operimi me makina (p.sh. motokultivatori).
Puna me pesticide (përfshirë trajtimin e farës).	Ekspozimi ndaj pesticideve dhe mjeteve tjera toksike.	Helmimet akute me pesticide (edhe me materie që përmbajnë plehtrat minerale). Efektet afatgjate në shëndetin e fëmijëve (problemet respiratore, neurologjike deri te kancerogjene).
Plehtërimi	Bartja e peshave të rënda. Orari i gjatë. Ekspozimi ndaj materieve toksike që përmbajnë plehtrat e ndryshëm.	Lodhja dhe dhimbjet e nyjeve dhe muskujve. Deformimet trupore. Helmimet akute nga materiet toksike të plehrave. Efektet afatgjate të materieve toksike në shëndetin e fëmijëve (problemet respiratorë, neurologjike deri te kancerogjene).

Aktiviteti	Rreziku	Efektet në shëndetin e fëmijëve
Transporti i farës	Makinat bujqësore. Peshat e rënda. Fara e trajtuar.	Lëndimet me makina, deri në fatalitet, nga aksidentet potenciale. Lodhja dhe dhembjet e muskujve dhe nyjeve. Deformimet trupore. Helmimet akute nga fara e trajtuar. Efektet afatgjate të materieve toksike në shëndetin e fëmijëve (problemet respiratorë, neurologjike deri te kancerogjene).
Kositja, mihja, korrje-shirjet	Përdorimi i mjeteve të mprehta, kosa, lopatat mihëse etj. Orari i gjatë i punës. Bartja e peshave të rënda gjatë bartjes së produkteve të korrura. Ekspozimi ndaj kushteve të pa favorshme klimatike.	Lëndimet nga mjetet e mprehta të punës. Deformimet afatgjate për shkak të pozitës së papërshtatshme të punës. Lodhje e madhe nga ngarkesa fizike. Irritimi i lëkurës, crregullimet diarreike, të vjellat, dehidrimi, e deri te goditja nga dielli.
Puna në serra	Temperaturat e larta Mbetjet e pesticideve Gazrat helmuese	Dehidratimi dhe lodhja e madhe, alivanosja. Dëmtimet e organeve respiratore. Helmimet nga mbetjet e pesticideve dhe gazrave tjerë në serrë (sidomos kur nuk janë të ajrosura mirë).
Ndërrimi i fidanëve të perimeve	Orari i gjatë i punës. Qëndrimi i trupit për kohë të gjatë në pozitë të pa favorshme për fëmijët.	Dëmtime të muskujve të këmbëve. Lodhje e madhe. Dëmtim i frymëmarrjes për shkak të kushteve të pa favorshme në serra.

3.1.4 Aktivitetet e ndaluara për fëmijë në mbrojtjen e bimëve

Përdorimi i preparateve të ndryshme për mbrojtjen e bimëve aktualisht ka përmasa shumë të mëdha dhe me tendencë të rritjes. Shumica e këtyre preparateve (gjatë manipulimit me to apo përdorimit të tyre) paraqesin rrezik potencial për shëndetin e njeriut. Dëmet që mund të shkaktojnë për shëndetin e njeriut janë shumë më të mëdha te fëmijët se sa tek të rriturit. Për këtë arsye duhet pasur kujdes që fëmijët të mbahen sa më larg pesticideve, në të gjitha fazat e përdorimit të tyre.

Tabela në vijim përmban disa nga aktivitetet e rrezikshme në fushën e mbrojtjes së bimëve, të ndaluara për fëmijë.

Aktiviteti	Rreziku	Efektet në shëndetin e fëmijëve
Përgatitja e solucionit për spërkatje	Materiet e ndryshme aktive të pesticideve.	Helmimet akute me pesticide (edhe me materje që përmbajnë plehurat minerale). Efektet afatgjate në shëndetin e fëmijëve (problemet respiratore, neurologjike deri te kancerogjene).
Hapja ose trajtimi i kontejnerëve (paketimeve) të pesticideve		
Trajtimi i bimëve (spërkatja)		
Pastrimi i pajisjeve të përdorura për spërkatjen e bimëve		

► Kujdes!

Fermerët duhet të marrin masa që fëmijët mos të jenë prezent dhe të mos përfshihen në asnjë fazë të përgatitjes, aplikimit apo ruajtjes së pesticideve.

3.1.5 Aktivitetet e ndaluara për fëmijë në ujitje

Ujitja është masë e rregullt në prodhimin bimorë në kushtet tona. Edhe pse nuk duket punë me shumë rrezik, puna në ujitje me sistem pompimi është e ndërlidhur me shumë rreziqe.

Tabela në vijim paraqet aktivitetet specifike që nuk guxon të kryhen nga fëmijët në kuadër të kësaj veprimtarie bujqësore.

Aktiviteti	Rreziku	Efektet në shëndetin e fëmijëve
Bartja e pajisjeve për ujitje (pompave, gypave, etj).	Peshat e rënda. Makinat e ndryshme për bartje.	Lëndimet e mundshme nga përdorimi i makinave të ndryshme për bartje. Lodhja dhe dhembjet e muskujve dhe nyjeve. Deformimet trupore.
Manipulimi me pompë të ujitjes me rrymë apo me naftë.	Rreziku nga rryma elektrike. Rreziku nga manipulime me lëndë djegëse.	Dëmtime të ndryshme si rezultat i ekspozimit për kohë të gjatë kushteve të pa favorshme klimatike (temperaturave të larta, ftohtit). Lëndime të ndryshme nga mjetet e punës dhe operimi me makina (p.sh. motokultivatori).
Puna me pesticide (përfshirë trajtimin e farës).	Ekspozimi ndaj pesticideve dhe mjeteve tjera toksike.	Lëndimet e ndryshme nga rryma apo lëndët djegëse që përdoren te pompat për ujitje.
Qëndrimi afër kanaleve të ujit apo puseve të thella që shërbejnë si burim i ujit	Kanali i ujit. Pusi.	Lëndime të ndryshme nga rrëshqitja, deri në fatalitet. Traumat e ndryshme.

3.1.6 Aktivitetet e ndaluara për fëmijë në aplikimin e plehrave minerale dhe organike

Përdorimi i plehrave minerale në prodhimtarinë bimore është shumë i përhapur. Plehrat minerale, ngjashëm me pesticidet, përveç dobisë që kanë në rritjen e rendimenteve të bimët, në rast të mos përdorimit profesional të tyre mund të paraqesin rrezik potencial për shëndetin e njeriut, posaçërisht fëmijëve.

Aktivitetet e ndaluara për fëmijë në këtë fushë janë listuar në tabelën vijuese.

Aktiviteti	Rreziku	Efektet në shëndetin e fëmijëve
Shpërndarja e plehrave.	Bartja e plehrave nga era. Bartja e peshave të rëndë. Orari i gjatë.	Helmimet e mundshme nga materiet që përmbajnë plehrat minerale. Deformimet trupore. Lodhja e madhe.
Drejtimi dhe manipulimi me makinat për shpërndarjen e plehut.	Makinat për shpërndarjen e plehut.	Lëndimet, deri në fatalitet, nga aksidentet potenciale.
Transporti i plehut (mineral apo organik)	Mjetet transportuese. Peshat e rënda.	Lëndimet, deri në fatalitet, nga aksidentet potenciale. Lodhja dhe dhembjet e muskujve dhe nyjeve. Deformimet trupore.
Bashkëngjitja dhe servisimi i makinave për shpërndarjen e plehut	Peshat e rënda Mjetet për rregullimin apo riparimin e makinave	Lëndimet fizike të gjymtyrëve. Lodhja dhe dhembjet e muskujve dhe nyjeve. Deformimet trupore.

► **Kujdes!**

Fermerët duhet të marrin masa që fëmijët mos të jenë prezent dhe të mos përfshihen në asnjë fazë të përgatitjes, aplikimit apo ruajtjes së plehrave minerale.

3.1.7 Aktivitetet e ndaluara për fëmijë në pylltari

Në shumë familje, sidomos në regjionet kodrinore-malore, shfrytëzimi i produkteve pyjore është pothuajse aktiviteti kryesor ekonomik. Për shkak se këtu nevojitet forcë më e madhe fizike zakonisht angazhohen fëmijë që janë mbi 14 ose 15 vjeç. Angazhimi i fëmijëve në punët e ndryshme të pylltarisë paraqet rrezik të lartë për ta.

Aktivitetet për ndalim të menjëhershëm në këtë fushë janë listuar në tabelën vijuese.

Aktiviteti	Rreziku	Efektet në shëndetin e fëmijëve
Punët në shfrytëzimin e masës drusore në pyje	<p>Operimi me makineri (traktor, kamion) në terrene të papërshtatshme.</p> <p>Përdorimi i mjeteve të mprehta dhe të rrezikshme për prerjen e drunjëve (motosharrë, sopatë, pykë, etj).</p> <p>Orari i gjatë i punës.</p> <p>Kafshët e egra, insektet, gjarpërinjtë.</p> <p>Ekspozimi ndaj kushteve të pa përshtatshme atmosferike.</p> <p>Peshat e rënda.</p>	<p>Lëndimet deri në fatalitet nga drejtimi dhe kontrollimi jo i mirë i makinerive që përdoren për tërheqje të masës drusore dhe transport në pylltari.</p> <p>Lëndime të ndryshme nga mjetet që përdoren për prerje.</p> <p>Lëndimet, deri në fatalitet, nga rrëzimi i trungjeve dhe degëve të thata.</p> <p>Lëndimet e ndryshme nga rrëshqitja, nga rrugët vështirë të kalueshme për të tërhequr dhe bartur trungjet e e prera.</p> <p>Plagë të ndryshme nga gjembat e drunjëve.</p> <p>Lëndimet nga sulmi i kafshëve të egra, helmimi nga kafshimi i gjarpërit apo infektimet nga pickimet e insekteve të ndryshme.</p> <p>Trauma nga frika permanente prej kafshëve të egra dhe gjarpërinjtë.</p> <p>Irritimi i lëkurës, crregullimet diarreike, të vjellat, dehidrimi, e deri te goditja nga dielli.</p>
Tërheqja dhe transporti i materialeve drusore		<p>Lëndimet deri në fatalitet nga drejtimi dhe kontrollimi jo i mirë i makinerive që përdoren për tërheqje të masës drusore dhe transport në pylltari.</p> <p>Lëndime të ndryshme të muskujve dhe/apo eshtrave nga bartja e drunjëve me pesha të rënda.</p>

Aktiviteti	Rreziku	Efektet në shëndetin e fëmijëve
Përpunimi primar dhe sekondar i drurit	Pajisjet dhe makineritë për përpunimin primar dhe sekondar të drurit Pluhuri Zhurma	Lëndime të ndryshme nga mjetet që përdoren për përpunim. Probleme të organeve respiratore. Dëmtimi i të pamurit dhe/apo të dëgjuarit, etj.
Punët silvi kulturore në pyje, pyllëzime dhe mbrojtja nga zjarri dhe sëmundjet	Përdorimi i mjeteve të mprehta. Bartja e peshave të rënda. Lëvizjet e përsëritura. Qëndrimi në pozita jo të përshtatshme gjatë operimit. Përfshirja nga zjarri pyjor.	Çrregullimet muskulore, Dëmtime të ndryshme të gjymtyrëve nga mjetet e punës. Djegia nga zjarri. Asfiksioni nga tymi.
Grumbullimi i produkteve jo drusore në pyje (bimët mjekësore, aromatike dhe frutat e malit)	Qëndrimi vetëm për kohë të gjatë në pyll. Lëvizja në terrene të papërshtatshme gjatë mbledhjes së produkteve jo drusore. Sulmet nga kafshët e egra. Pickimi nga insektet e ndryshme, gjarpërinjtë. Kushtet atmosferike.	Lëndimet e ndryshme nga rrëshqitja. Lëndimet nga sulmi i kafshëve të egra, helmimi nga kafshimi i gjarpërit apo infektimet nga pickimet e insekteve të ndryshme. Trauma nga frika permanente prej kafshëve të egra apo gjarpërinjëve. Lodhja e madhe. Dëmtimi i muskujve dhe eshtrave.
Aktivitetet në gjueti dhe kultivim të kafshëve të egra	Armët Kurthat Sulmet nga kafshët e egra Peshat e rënda Sëmundjet e kafshëve të egra.	Plagosjet nga armët e gjuetisë, deri në fatalitet. Lëndimet nga kurthet. Lëndimet nga kafshët e egra. Lëndimet e muskujve apo organeve tjera si rezultat i bartjes së peshave të rënda. Deformimet trupore. Traumata psikologjike. Epidemitë dhe sëmundjet nga kafshët e egra.

3.1.8 Aktivitetet e ndaluara për fëmijë në bujqësinë organike

Bujqësia organike tek ne është në fillet e saj. Deri me tani kryesisht janë të çertifikuara si prodhime organike vetëm disa produkte pyjore jo drusore që njihen si bimë mjekësore aromatike. Disa nga këto bimë edhe kultivohen në sipërfaqe të konsiderueshme në Kosovë. Shumica e këtyre produkteve janë të orientuara për eksport. Rritja e këtij sektori ka krijuar rrethana të favorshme edhe për angazhimin e shumë fëmijëve të zonave kodrinore malore, sidomos në mbledhjen e bimëve të ndryshme mjekësore në pyje.

► **Kujdes!**

Kompanitë që mirren me kultivimin dhe grumbullimin e produkteve organike duhet të zbatojnë ndalesat e përcaktuara në tabelën vijuese.

Aktiviteti	Rreziku	Efektet në shëndetin e fëmijëve
Mbledhja e bimëve mjekësore aromatike në pyje	<p>Qëndrimi vetëm për kohë të gjatë në pyll.</p> <p>Terreni i papërshtatshëm.</p> <p>Sulmet nga kafshët e egra, pickimi nga insektet e ndryshme dhe gjarpërinjtë.</p>	<p>Lëndimet e ndryshme nga rrëshqitja dhe nga rrugët vështirë të kalueshme.</p> <p>Lëndimet nga sulmi i kafshëve të egra, helmimi nga kafshimi i gjarpërit apo infektimet nga pickimet e insekteve të ndryshme.</p> <p>Trauma nga frika permanente prej kafshëve të egra dhe gjarpërinjëve.</p> <p>Lodhja e madhe.</p> <p>Dëmtimi i muskujve dhe eshtrave.</p>

Aktiviteti	Rreziku	Efektet në shëndetin e fëmijëve
Përgatitja e tokës për mbjelljen e bimëve	Përdorimi i makinave bujqësore. Zhurma e madhe. Qëndrimi për kohë të gjatë në fushë/ekspozimi ndaj kushteve të pafavorshme atmosferike.	Lëndimet deri në fatalitet nga drejtimi dhe kontrollimi jo i mirë i makinerive bujqësore. Dëmtimi i të dëgjuarit. Irritimi i lëkurës, çrregullimet diarreike, të vjellat, dehidrimi, e deri te goditja nga dielli.
Bartja e produkteve	Përdorimi i makinave Peshat e rënda	Lëndimet deri në fatalitet nga drejtimi dhe kontrollimi jo i mirë i makinerive bujqësore. Lëndimet e muskujve apo organeve tjera si rezultat i bartjes së peshave të rënda.
Përpunimi i produkteve organike	Tharëset e produkteve organike. Pajisjet e mprehta për përpunim.	Lëndimet nga tharëset dhe pajisjet tjera që përdoren për tharje dhe përpunim.

3.1.9 Ndalesat në përdorimin e mekanizimit bujqësor

Niveli i përdorimit të mekanizimit bujqësor është aktivitet (pothuajse) i përditshëm në punët e bujqësisë.

► **Kujdes!**

Përveç nga përdorimi i makinave bujqësore (që nuk është i lejuar), fëmijët shumë shpesh e pësojnë edhe nga qëndrimi në pjesë të ndryshme të traktorit apo makinave bujqësore që nuk janë të lejuara për qëndrim në to gjatë punës.

Shumica e makinave që përdoren në bujqësi kategorizohen me rrezik të lartë për shëndetin e njeriut. Për këtë arsye gjatë punës me pajisje bujqësore, makina bashkangjitive e posaçërisht me traktor lëndimet mund të jenë të shpeshta e në disa raste edhe me fatalitet.

► **Kujdes!**

Rastet më të shpeshta me fatalitet në bujqësi janë ato me traktor dhe mekanizim tjetër bujqësor.

Aktiviteti	Rreziku	Efektet në shëndetin e fëmijëve
Drejtimi i traktorit, autokombajnës apo moto kultivatorit	Rrëzimi nga makina. Ndeshja me objekte tjera. Aksidentimi i të tjerëve.	Lëndimet e rënda me pasoja afatgjate te fëmijët, deri në fatalitet. Dëmtimi i të dëgjuarit.
Ulja e fëmijëve së bashku me drejtuesit e këtyre makinave	Rrëzimi nga makina. Pozita e papërshtatshme e trupit.	Aksidente deri në fatalitet për fëmijët. Rreziku i deformimit të trupit për shkak të qëndrimit për kohë të gjatë në pozitës të papërshtatshme.
Bashkangjytja e makinave të ndryshme	Pesha e rëndë. Pjesët e mprehta të makinave.	Dëmtime të gjymtyrëve. Dëmtime të muskujve, nyjeve dhe organeve tjera. Deformim i trupit.
Servisimi i makinave apo pajisjeve të ndryshme bujqësore	Pjesët e mprehta të makinave. Vajrat e ndryshme që përdoren për servisim.	Lëndimet fizike. Dëmtime të lëkurës së duarve si rezultat i përdorimit të vajrave të ndryshme gjatë servisimit.
Parkimi i makinave	Aksidentet nga pa mundësia e drejtimit si duhet nga ana e fëmijëve	Aksidentet e ndryshme, rrezikimi (jo vetëm i fëmijëve por edhe personave tjerë në afërsi) në disa raste edhe me fatalitet.

Gjatë punës me makina bujqësore fëmijët duhen të rrinë larg në mënyrë që mos të dëmtohen nga zhurma, pluhuri, gazrat e ndryshme që lëshojnë këto makina gjatë punës së tyre. Gjatë parkimit të makinave duhet pasur kujdes që ato të jenë të parkuara në mënyrë të sigurt dhe mos të vihen në punë nga ana e fëmijëve.

3.1.10 Aktivitetet e ndaluara për fëmijë në agropërpunim

Rreziqet nga angazhimi i fëmijëve në industrinë përpunuese janë evidente në të gjithë sektorët e përpunimit të ushqimit. Në industrinë e përpunimit të mishit fëmijëve nuk u lejohej asnjë aktivitet, ndërsa në industritë tjera ndalohej përfshirja e fëmijëve në aktivitetet e listuara në tabelën vijuese.

Aktiviteti	Rreziku	Efektet në shëndetin e fëmijëve
Bartja e lëndës së parë për përpunim	Përdorimi i makinave	Aksidente me makina.
Bartja e produkteve të ndryshme të përpunuara	Peshat e rënda	Lëndime të ndryshme (si pasojë e manipulimit me pesha të rënda), me pasoja afatgjate për fëmijën.
Puna me pajisje për përpunim	GrinMullinjtë për bluarje, prerëset e ndryshme.	Lëndime të ndryshme deri me fatalitet
Puna me energjinë që furnizon pajisjet	Rreziku nga energjia elektrike	Lëndime të ndryshme nga rryma.
Servisimi i pajisjeve	Rreziku i lëndimeve të ndryshme fizike	Lëndime nga pajisjet që mund të jenë mjaft delikate në njësitë e përpunimit.
Puna në thertore dhe përpunimi i mishit	Mjetet që përdoren për therrje. Ekspozimi ndaj procesit të therrjes. Peshat e rënda	Prerjet dhe lëndimet e gjymtyrëve. Trauma psikologjike. Lëndime të ndryshme (si pasojë e manipulimit me pesha të rënda), me pasoja afatgjate për fëmijën.

3.1.11 Aktivitetet e ndaluara për fëmijë në sektorin jo bujqësor

Duke marrë parasysh sipërfaqen e kufizuar të tokës për një familje dhe dendësinë e popullsisë në Kosovë, është e qartë se vetëm bujqësia nuk mund të sigurojë zhvillim të sukseshëm rural. Zhvillimi i sektorit jobujqësor në zonat rurale mund të ndikoj dukshëm në ngritjen nivelit të të ardhurave dhe uljen e papunësisë pasi që efekti i sektorit të bujqësisë është i vogël në këtë aspekt. Aktivitet jo bujqësor mund të jenë nga më të ndryshmet (njësi të vogla përpunimi, artizanate të ndryshme si shumë aktivitete të ndryshme shërbyese dhe prodhuese).

► **Kujdes!**

Pa marrë para syshë llojin e aktivitetit jobujqësor, është me rëndësi që gjatë ushtrimit të kësaj veprimtarie të respektohen ndalesat përkatëse të listuara në Udhëzimin Administrativ për Parandalimin dhe eliminimin e punëve të rrezikshme për fëmijë në Kosovë.

3.2 Cila punë është e përshtatshme për fëmijë?

Për t'u cilësuar si punë e përshtatshme për fëmijë, e gjithë natyra dhe kushtet e punës duhet të mos paraqesin rrezik dhe të jenë të përshtatshme për moshën dhe aftësitë psikofizike të një fëmije, të mos interferojnë me shkollimin dhe të mos pengojnë fëmijën në shfrytëzimin e kohës së lirë. Këto lloje aktivitete kontribuojnë në zhvillimin e fëmijëve dhe në mirëqenien e familjeve të tyre, u sigurojnë atyre aftësi dhe përvojë pune, duke i përgatitur për të qenë anëtarë produktivë dhe të përgjegjshëm të shoqërisë.

Përveç këtyre situatave të përgjithshme të angazhimit të fëmijëve, **puna e lejuar për fëmijë** i referohet situatave kur fëmija ka arritur moshën minimale për punësim (moshën 15 vjeçare) dhe (me pëlqimin e prindit ose kujdestarit ligjor), është angazhuar në aktivitete ekonomike jo të dëmshme për zhvillimin dhe shëndetin e tij/saj, dhe veçanërisht që nuk e pengon atë të ndjekë shkollimin dhe të luaj (shih Tabelën 1).

Prandaj, duke pasur parasysh se bujqësia vazhdon të luajë një rol qendror në ofrimin e mundësive të punësimit dhe gjenerimit të të hyrave për punëtorët e rinj dhe të rritur (sidomos për ata që jetojnë në zona rurale), fëmijët duhet dalëngadalë dhe nën kujdesin e të rriturve të familjarizohen me punën në fermë, duke u angazhuar në forma të lehta dhe të lejuara të punës por gjithnjë duke pasur parasysh rreziqet e mundshme gjatë punës në fermë.

► **Kujdes!**

Për të përcaktuar nëse një punë mund të lejohet për fëmijë duhet ti keni parasysh pyetjet në vijim:

- A do ti merr kjo punë fëmijës shumë kohë, duke e penguar në vijimin e shkollës?
- A do ta lodh kjo punë fëmijën duke ia vështirësuar apo pamundësuar kryerjen e detyrave të shtëpisë?
- A do t'ia merr kohën e lojës dhe argëtimit?
- Si do të ndihet fëmija emocionalisht gjatë kryerjes së punës?
- A ka ndonjë veprim (në kuadër të punës) që mund ta bëjë fëmijën të ndjehet i pasigurtë, i përjashtuar apo i rrezikuar/kërcënuar?
- Si ndihet fizikisht fëmija gjatë kryerjes së punës? Po pas punës?
- A përfshihet në punë edhe shfrytëzimi apo qëndrimi në afërsi të substancave kimike, makinerisë së rëndë apo mjeteve të mprehta?
- A është ndonjë aktivitet punues i ndaluar me legjislacion apo illegal¹⁸?

¹⁸ Child Work, Child Labor, ECLT Foundation, gjendet në: <https://www.eclt.org/en/news/what-is-child-labour>

▶ 4

Referencat



Referencat:

1. Child labour, Global estimates 2020, Trends and the road forward, International Labour Organization and United Nations Children's Fund, New York 2021 gjendet në: https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed_norm/---ipec/documents/publication/wcms_797515.pdf
2. Profili i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, Promovimi i punës së denjë përmes forcimit të menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë, si dhe dialogut social në Kosovë, Organizata Ndërkombëtare e Punës, Prishtinë 2021.
3. Anketa e grupimeve të treguesve të shumëfishtë 2019-2020 për Republikën e Kosovës dhe Anketa e grupimeve të treguesve të shumëfishtë 2019-2020 për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës, Raporti i gjetjeve të anketës, Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe UNICEF, Prishtinë 2020 gjendet në: https://ask.rks-gov.net/media/5765/republic-of-kosovo-national-and-roma-ashkali-and-egyptian-communities-2019-20-mics-sfr_albanian.pdf
4. Towards the urgent elimination of hazardous child labour, International Labour Office, Fundamental Principles and Rights at Work Branch (FUNDAMENTALS) – Geneva, ILO, 2018 gjendet në: [file:///C:/Users/XPS/Downloads/WDAACL2018_Technical_Report_FINAL_EN_20180612%20\(1\).pdf](file:///C:/Users/XPS/Downloads/WDAACL2018_Technical_Report_FINAL_EN_20180612%20(1).pdf)
5. A special module on child labour in agriculture: SCREAM Stop child labour! International Labour Office, International Programme on the Elimination of Child Labour (IPEC); Fundamental Principles and Rights at Work Branch (FUNDAMENTALS), Geneva: ILO, 2017 gjendet në: https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed_norm/---ipec/documents/instructionalmaterial/wcms_819567.pdf
6. Smjernica dobre prakse: Rizici u poljoprivredu, Hrvatski zavod za zastitu zdravlja i sigurnost na radu, Zagreb 2015 gjendet në: <http://www.hzzsr.hr/wp-content/uploads/2016/11/Smjernica-za-siguran-rad-u-poljoprivredi.pdf>
7. Handbook for monitoring and evaluation of child labour in agriculture, Food and Agriculture Organization of the United Nations, Rome 2015 gjendet në: https://www.fao.org/3/i4630e/i4630e.pdf?utm_source=visiting+cards&utm_medium=qr&utm_campaign=occ-book-cards
8. Udhëzimi Administrativ QRK nr. 05/2013 për Parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijëve në Kosovë gjendet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10297>
9. Protecting health and safety of workers in agriculture, livestock farming, horticulture and forestry, European Commission, Directorate-General for Employment, Social Affairs and Inclusion, December 2011 gjendet në: file:///C:/Users/XPS/Downloads/OSH_workers_agriculture_livestock_farming.pdf
10. Child labour prevention in agriculture. Junior Farmer Field and Life School - Facilitator's guide, FAO, Rome 2010 gjendet në: <https://www.fao.org/3/i1897e/i1897e.pdf>
11. Safety and health in agriculture, International Labour Office, Programme on safety, health and the environment- Labour Protection Department, Geneva 2011 gjendet në: https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/@ed_protect/@protrav/@safework/documents/publication/wcms_110193.pdf
12. Child Labor and Health Handouts: Adult Education Workshop, University of Iowa Labor Center, 2004 gjendet në: https://laborcenter.uiowa.edu/sites/laborcenter.uiowa.edu/files/wysiwyg_uploads/clpephealthhandouts.pdf

